

VENDIM
Nr. 121, datë 26.2.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 845, DATË 28.10.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
HOLLËSISHME PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE TURISTIKE DETARE, QË
KRYHEN NËPËRMJET MJETEVE LUNDRUESE PËR QËLLIME TURISTIKE
DHE ARGËTIMI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që i bashkëlidhet vendimit nr. 845, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Kudo në tekst, fjalët “... i/ licencuar si operator turistik me licencën me kodin XIII.1.B, “Operator turistik”, dhe ...” hiqen.

2. Në pikën 1, të kreut I, fjalët “... të licencuar si “Operator turistik”, me kodin XIII.1.B dhe ...” hiqen.

3. Në pikën 10, të kreut I, fjalët “... i licencuar me licencën me kodin XIII.1.B si “Operator turistik” dhe ...” hiqen.

4. Në shkronjën “a”, të pikës 6, të kreut II, fjalët “... licenca si operator turistik ...” hiqen.

5. Në pikën 1, të kreut VII, fjalët “... licencuar e ...” hiqen.

II. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku